



ProCredit Bank
Kosovo

***Njoftim i privatësisë nga
Banka ProCredit Kosovë***

Banka ProCredit SH.A. kontrollon dhe përpunon të dhënat personale që jepen nga personat fizik kur shfrytëzojnë shërbimet që ne ofrojmë, qoftë përmes marrëdhënies së biznesit apo përmes pranisë online kur përdorin uebfaqen, aplikacionin në internet dhe aplikacionin mobil.

Më tutje në tekst, termat “Banka”, “ne” dhe termat që rrjedhin prej tyre i referohen Bankës ProCredit SH.A. (zyra që gjendet në Rrugën George Bush, nr. 26, 10000 Prishtinë, Kosovë). Termi “ju” dhe termat që rrjedhin prej tij i referohen përdoruesit të shërbimeve tona. Termi “njoftim i privatësisë” i referohet këtij dokumenti. Termi “uebfaqe” i referohet <https://www.procreditbank-kos.com/>, “aplikacioni në internet” i referohet <https://ebanking.procreditbank-kos.com/>, dhe “aplikacion” i referohet ProCredit Kosovo in App Store dhe ProCredit Mobile Banking Kosovo in Google Play.

Ky njoftim i privatësisë përshkruan se si i përpunojmë ne të dhënat personale. Rregullat e paraqitura në këtë dokument vlejné për çdo formë të të dhënave, qofshin të ruajtura në mënyrë elektronike apo në letër, apo në pajisje të tjera ku ruhen të dhënat.

Përmbajtja:

1.	Parimet e mbrojtjes së të dhënave	4
2.	Përkufizimet	4
3.	Cilat të dhëna personale i përpunon Banka?	5
4.	Si i mbledh Banka të dhënat tuaja personale?	6
5.	Cilat janë qëllimet e përpunimit të të dhënave personale?	7
6.	Cila është baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale?	7
7.	Si detyrohet Banka nga dokumenti i pajtimit?	8
8.	Si i përpunon Banka të dhënat tuaja personale?	8
9.	Identifikimi me video dhe nënshkrimi elektronik	8
10.	Cilat janë të drejtat për mbrojtjen e të dhënave tuaja?	9
11.	Çfarë janë kërkesat për qasje në subjektet e të dhënave?	9
12.	Kur mund t'i transferojë Banka të dhënat tuaja personale?	10
13.	Cila është periudha e ruajtjes së të dhënave personale apo kriteret për përcaktimin e periudhës së ruajtjes?	10
14.	Çfarë janë cookies?	11
15.	Ç'lloj të të dhënave dhe informatave të përgjithshme mbledh Banka?	11
16.	Përse Banka përdor cookies dhe mbledh të dhëna dhe informata të përgjithshme?	11
17.	Si munden përdoruesit t'i menaxhojnë cookies?	12
18.	Google Analytics (Analitika e Google)	12
19.	Përpunimi i të dhënave gjatë përdorimit të bisedës më klientë	12
20.	Përditësime të njoftimit të privatësisë	12

1. Parimet e Mbrojtjes së të Dhënave

Banka është tërësisht në pajtueshmëri me rregulloret që rregullojnë mbrojtjen dhe privatësinë e të dhënave, në veçanti Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ligjet e tjera të zbatueshme vendore dhe Rregulloren për Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme (EU) 2016/679 të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian (më tutje në tekst “GDPR”). Kjo siguron që mbrojtja e personave fizik lidhur me përpunimin e të dhënave të tyre personale, kur ata kërkojnë shërbime nga Banka, është në pajtueshmëri me masat mbrojtëse dhe detyrimet e zbatueshme ligjore.

Banka është e përkushtuar për përpunimin e të gjitha të dhënave personale që ka nën kontroll, në përputhje me parimet e ndërlidhura me përpunimin e të dhënave personale. Prandaj, të dhënat personale:

- Përpunohen në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente (ligjshmëria, drejtësia dhe transparencja)
- Mbledhen vetëm për qëllime specifike, eksplicite dhe legjitime (qëllimi i kufizimit)
- Janë të duhura, relevante dhe jo të tepërta për qëllimet mbi cilat përpunohen të dhënat personale (minimizimi i të dhënave)
- Janë të sakta dhe aty ku vlen, të azhuruara (saktësia)
- Nuk ruhen më gjatë se sa është e nevojshme për qëllimet për të cilat përpunohen të dhënat personale, apo ashtu si e kërkon ligji (kufizimi për ruajtje)
- Përpunohen nën masat e duhura të sigurisë për të dhënat personale (integriteti dhe konfidencialiteti)

Banka është përgjegjëse për pajtueshmërinë me parimet e lartpërmendura. Nëse keni pyetje të tjera apo keni përshtypjen se ndonjë aspekt në interesin tuaj nuk është adresuar në këtë njoftim të privatësisë, kontaktoni Zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave (ZMDH) kaltrina.haxha@procredit-group.com.

2. Përkufizimet

Për qëllime të njoftimit për privatësinë, vlejné përkufizimet e Nenit 4 të GDPR.

- Të dhëna personale nënkupton çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (subjekt i të dhënave); person i identifikueshëm është personi i cili mund të identifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në veçanti në bazë të një numri të identifikimit ose të një e më shumë faktorëve të veçantë mbi identitetin e tij ose saj fizik, psikologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror;
- Kontrollues i të dhënave nënkupton çdo person fizik ose juridik nga sektori publik ose privat, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që individualisht apo së bashku me të tjerët, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave, apo një person i caktuar me ligj që po ashtu përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit;
- Përpunues i të dhënave nënkupton çdo person fizik ose juridik nga sektori publik ose privat, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që përpunon të dhënat personale për dhe në llogari të kontrolluesit të të dhënave;
- Pajtimi i subjektit të të dhënave nënkupton çdo indikacion të dhënë lirishëm, në mënyrë specifike, të informuar dhe të qartë për dëshirat e subjektit të të dhënave me anë të të cilit ai ose ajo, përmes deklaratës ose veprimit të qartë afirmues, konfirmon pajtimin për përpunimin e të dhënave personale të tij/saj;
- Përpunimi nënkupton çdo veprim ose seri veprimesh që kryhen ndaj të dhënave personale me mjete automatike ose jo, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, tërheqja, konsultimi, përdorimi, publikimi nëpërmjet transmetimit, shpërndarja ose ofrimi, njësimi ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose asgjësimi;

3. Cilat të Dhëna Personale përpunon Banka?

Banka përpunon të dhëna personale për të ofruar shërbimet e veta ose kur kjo i kërkohet me ligj. Kategoria e të dhënave personale që përpunohen varet nga shërbimet e kërkuara dhe produktet që shfrytëzon klienti. Për shembull, nëse doni të caktoni një takim me Bankën lidhur me shërbimet bankare, duhet të jepni emrin dhe mbiemrin tuaj, numrin e telefonit, email adresën, numrin identifikues personal dhe rajonin. Megjithatë, nëse doni të hapni llogari duke përdorur uebfaqen, duhet të jepni më shumë të dhëna personale. Prandaj, të dhënat personale që Banka posedon ndahen në nën kategori të ndryshme, sikurse janë paraqitur në listën më poshtë. Mirëpo kjo listë nuk është kufizuese, pasi klienti mund të përdorë edhe shërbime dhe produkte të tjera që kërkojnë përpunim të të dhënave personale shtesë.

Kategoria	Përshkrimi
Identiteti dhe informatat kontaktuese	<ul style="list-style-type: none"> • Emri dhe mbiemri • Gjinia • Kombësia • Statusi i banimit • Dokumenti i identifikimit ose pashaporta (numri personal i identifikimit, lloji i dokumentit, numri i dokumentit, autoriteti që e ka lëshuar, data e lëshimit, data e skadencës) • Data e lindjes • Vendi i lindjes • Adresa postare (vendi, rajoni i vendit, kodi zip, qyteti, adresa e rrugës) • Informatat kontaktuese (adresa personale e emailit, numrat e telefonit të shtëpisë dhe mobilit, numri i telefonit të punës; adresa e emailit të punës) • Statusi martesor • Detaje familjare • Përvoja profesionale • Pozicioni dhe vendi i punës • Arsimi • Të dhëna autentifikimi (mostra e nënshkrimit) • Fotografi • Statusi FATCA dhe numri TIN • Statusi PEP
Informata financiare	<ul style="list-style-type: none"> • Statusi financiar dhe hollësi për të ardhurat • Statusi i punësimit dhe punësimi i të afërmeve • Historia e kredive • Evidenca për vlerësimin kreditor • Të dhëna nga regjistrat publik • Marrëdhënia me banka ose kompani financiare të tjera • Evidenca e biznesit për individë të vetëpunësuar • Dokumentacioni për pronat (përshkrimi i pronës, raporti për vlerësimin e pronës, sigurimi i kolateralit, dokumentacioni për ndërtim)
Informata lidhur me produktet dhe shërbimet e Bankës	<ul style="list-style-type: none"> • Të dhëna nga përmbushja e detyrimeve kontraktuale • Hollësi për llogarinë bankare • Hollësi për kartën e kreditit/debitit • Hollësi dhe historiku i transaksioneve • Të dhëna lidhur me marrëveshjet për autorizime • Informata për palë të treta përfituese • Të dhëna të tjera për përdorimin e produkteve dhe shërbimeve të Bankës

Kategoria	Përshkrimi
Informata teknike dhe identifikimi online	<ul style="list-style-type: none"> Të dhëna për regjistrimin dhe abonimin e përdoruesit (p.sh. kredencialet e regjistrimit për bankimin online) Hollësi të lokacionit nga pajisja mobile apo tjetër Identifikues unik për pajisjen tuaj Adresa e IP e pajisjes me të cilën i jeni qasur shërbimeve bankare Hollësi mbi pajisjen dhe teknologjinë që përdorni Të dhëna për tregtarët ku paguani me kartën tuaj Të dhëna për cookies që përdor uebfaqja
Kategori të ndjeshme të të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> Informata për shëndetin Informata për dënime penale <p><i>* Banka mbledh të dhëna personale që kanë të bëjnë me fëmijët vetëm në pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe pasi ka marrë pajtimin eksplisit të prindërve apo kujdestarëve ligjorë të tyre.</i></p>
Lloje të tjera të të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> Pamje nga kamerat e sigurisë në dhe rreth mjediseve të bankës dhe zonave 24/7 Regjistrime zanore Ankesa dhe informata lidhur me ekzekutimin e të drejtave të subjektit të të dhënave Të dhëna nga hetimet (p.sh. sanksione dhe kontrollat kundër shperlarjes së parave)

4. Si i mbledh Banka të Dhënat tuaja Personale?

Banka i mbledh të dhënat tuaja personale kryesisht kur ju përdorni shërbimet dhe produktet që ne ofrojmë, apo platformat tona online. Ne i mbledhim të dhënat tuaja personale kur ju:

- Hapni një llogari dhe/ose regjistroheni si klient
- Aplikoni për ndonjë nga produktet apo shërbimet tona, si depozitë me afat, kredi për shtëpi, kredi për investime, etj.
- Përdorni shërbimet bankare si E-banking dhe M-banking, etj.
- Përdorni ose shikoni uebfaqen tonë përmes cookies të shfletuesit tuaj
- Vizitoni degët apo zyret tona apo përdorni zonat 24/7 të bankës
- Kontakttoni bankën përmes emailit apo formularit të kontaktimit, përmes thirrjeve telefonike nëpërmjet qendrës së thirrjeve apo kanaleve të tjera të komunikimit
- Ofroni informacion, ose me gojë ose me shkrim, përmes emailit, aplikacioneve ku mund të parashtroni ankesat, formularëve të aplikimit, kontratave apo kaneleve të tjera të komunikimit

Banka mund t'i mbledhë të dhënat tuaja, brenda kufijve të lejuar me ligj, edhe indirekt nga entitete ligjore, individët, entiteteve të tjera brenda grupit ProCredit, apo edhe burimeve të tjera, përfshirë:

- Regjistrat publikë (p.sh., Regjistri Qendror i Kredive, regjistri pronësor, uebfaqja e Policisë për vlefshmërinë e verifikimit të kartave të identitetit)
- Palët e ndërlidhura në aspektin shoqëror ose ekonomik (p.sh., punëdhënës, pronarë të bizneseve, të afërm ose persona të tjerë)
- Autoritetet publike dhe agjencitë për zbatimin e ligjit
- Agjencitë e rekrutimit

5. Cilat janë qëllimet e përpunimit të të Dhënave Personale?

Banka i përpunon të dhënat tuaja personale kryesisht për të krijuar, ofruar dhe ekzekutuar shërbimet dhe produktet e veta, siç janë shërbimet financiare, dhe mbështetet tek një sërë bazash ligjore për përpunimin e të dhënave personale. Qëllimet e përdorimit të të dhënave personale përfshijnë:

- Përpunimin e aplikimeve të subjekteve të të dhënave për shërbime dhe produkte që ofron Banka
- Përpunimin e pagesave dhe transaksioneve të tjera për ose nga subjektet e të dhënave
- Përpunimin e të dhënave në lidhje me përbushjen e detyrimeve kontraktuale për çdo produkt dhe shërbim bankar
- Ofrimin e shërbimeve dhe produkteve me cilësi të lartë dhe të afatgjatë
- Përbushjen e detyrimeve ligjore dhe rregullative (siç është, raportimi dhe përgjigjja ndaj kërkesave të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës)
- Verifikimin e identitetit të subjekteve të të dhënave
- Verifikimin e klasifikimit kreditor
- Parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe mashtrimit
- Kontrollimin dhe raportimin e detyrimeve sipas kërkesave ligjore
- Përmirësimin e shërbimeve të klientëve dhe menaxhimin e marrëdhënieve me klientë
- Nxitjen e zhvillimit të biznesit
- Sigurimin e menaxhimit të duhur të rrezikut
- Ruajtjen e interesave legjitime të Bankës (p.sh vëzhgimi me kamera, sqarimi i diferencës në kesh, zgjidhja e ankesave të klientëve etj.)

Vendimmarrja dhe profilizimi i automatizuar

Banka nuk e përdor profilizimin dhe vendimmarrjen e automatizuar kur krijon raporte pune me subjektin e të dhënave.

Mirëpo, Banka mund të përdorë vendimmarrje dhe profilizim të automatizuar për të kontrolluar individët, kompanitë, transaksionet e dyshimta apo për të identifikuar pagesat që u nënshtrohen sanksioneve ndërkombëtare lidhur me parandalimin e pastrimit të parave, mashtrimit dhe financimit të terrorizmit.

6. Cila është baza ligjore për përpunimin e të Dhënave Personale?

Banka i përpunon të dhënat tuaja personale nëse vlenë së paku një nga pikat e mëposhtme:

- Subjekti i të dhënave e ka dhënë pajtimin për përpunimin e të dhënave personale të tij apo të saj për një apo më shumë qëllime specifike
- Përpunimi është i nevojshëm për përbushjen e kontratës në të cilën është palë subjekti i të dhënave apo për të ndërmarrë hapa me kërkesë të subjektit të të dhënave para se të hyjë në kontratë me të
- Përpunimi është i nevojshëm për të qenë në pajtueshmëri me detyrimin ligjor të cilit i nënshtrohet Banka
- Përpunimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesat jetike të subjektit të të dhënave apo të personit tjetër fizik
- Përpunimi është i nevojshëm për kryerjen e detyrës që ka interes publik apo ushtruar detyrat zyrtare që bien nën përgjegjësinë e Bankës
- Përpunimi është i nevojshëm për qëllime të interesave legjitime që ndjek Banka apo pala e tretë, me përjashtim të rasteve kur këto interesa tejkalohen nga interesat apo të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave, që kërkojnë mbrojtjen e të dhënave personale, sidomos kur subjekti i të dhënave është fëmijë

7. Obligimet e Bankës në raport me pajtimin e dhënë nga ju

Nëse përpunimi i të dhënave personale është i nevojshëm dhe nuk ka bazë statutores për këtë përpunim, Banka merr pajtimin nga subjekti i të dhënave.

Pajtimi juaj është i revokueshëm në çdo kohë dhe ju mund ta tërhiqni pajtimin në të njëjtën formë sic e keni dhënë ose nëpërmjet kanaleve tona të kontaktit pa pagesë. Tërheqja e pajtimi nuk ndikon në ligjshmërinë e përpunimit në bazë të pajtimit para tërheqjes së tij.

8. Si i përpunon Banka të dhënat tuaja personale?

Banka i përpunon të dhënat në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe transparente, në përmbushje të kërkesave të ligjeve të zbatueshme duke ofruar mbrojtje nga përpunimi i paautorizuar ose i kunderligjshëm, dhe nga humbjet apo shpalosjet aksidentale të të dhënave personale, duke përdorur masat e duhura teknike dhe organizative. Banka ka krijuar entitete për sigurinë e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave, si Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Zyrtari për Sigurinë e Informacionit.

Banka vë në zbatim masat e duhura teknike dhe organizative në atë mënyrë që realizon sigurinë më të lartë të mundshme, të përshtatshme për nivelin e rrezikut, në mënyrë që të mbrojtë të dhënat tuaja personale, për shembull duke përdorur mbrojtjen e pajisjeve dhe të të dhënave, kontrollin në qasje dhe të drejtat në qasje, verifikimin e identitetit të përdoruesit etj.

Në rastet kur të dhënat personale përpunohen në emër të Bankës, Banka hyn në kontratë të veçantë me përpunuesin ose nën-përpunuesin dhe specifikon qartazi detyrimet e njejta sa i përket mbrojtjes së të dhënave personale, për të siguruar pajtueshmëri me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave dhe GDPR si dhe zbatimin e masave të kërkuara teknike dhe organizative për mbrojtjeën e të drejtave të subjektit të të dhënave.

9. Identifikimi me video dhe nënshkrimi elektronik

Banka ProCredit është e detyruar me ligj që t'a kontrollojë identitetin tuaj duke përdorur dokument identifikimi të vlefshëm, gjatë procesit të hapjes së llogarisë së re dhe ruajtjes së informacionit specifik nga dokumenti i identifikimit. Për këtë qëllim, ju kryhet drejtpërdrejt procesi i identifikimit me fotografi dhe video, nëpërmjet partnerit tonë të mirëbesuar InfoCert S.p.A (më tutje në tekst InfoCert). Ky proces përbëhet nga tre nënprocese kryesore: mbledhja e provave për identitetin, detektimi i drejtpërdrejt i procesit të identifikimit me fotografi dhe video dhe nënshkrimi elektronik i dokumenteve/kontratave. I gjithë procesi kryhet përmes telefonit mobil në aplikacionin vendas (iOS dhe Android). Për të zhvilluar procesin e detektimit të ngjashmërisë përmes identifikimit me foto dhe video, të dhënat personale mblidhen si provë e pranueshmërisë tuaj për të shfrytëzuar shërbimet tona.

Në fillim të procesit të identifikimit përmes videos, stafi ynë do t'ju kërkojë të shprehni pajtimin në përputhje me Nenin 5, Paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për marrje fotosh dhe regjistrim bisedash. Në të dyja rastet, identiteti verifikohet përmes procesit të identifikimit për detektim të ngjashmërisë me foto dhe video përmes një linje të koduar transmetimi. Banka Procredit mund të transmetojë të dhëna personale tek ofruesit e jashtëm të shërbimeve për të verifikuar identitetin tuaj. Sa i përket procesit të identifikimit përmes detektimit të ngjashmërisë me foto dhe video nga InfoCert, ne i referohemi Kushteve dhe Rregullave të Infocert, që ju ofrohen në kuadër të procesit të identifikimit. Përpunimi i të dhënave personale arsyetohet në bazë të Nenit 5, Paragrafi 1.1 dhe Paragrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Pas autorizimit tuaj për ta bërë këtë, stafi ynë qaset në kamerën e pajisjes tuaj dhe ju bëjnë një foto bashkë me videon ku ju kërkohet që të lëvizni dhe të tregoni pjesën ballore dhe ato anësore të dokumentit tuaj të identifikimit apo të faqes kryesore të pasaportës. Juve do t'ju kërkohet t'a identifikoni veten direkt përmes sesionit me video të drejtpërdrejt. Gjatë procesit të identifikimit me video, stafi ynë do të sigurojë autenticitetin e dokumentit tuaj të identitetit personal apo të pasaportës. Fotoja dhe videoja e drejtpërdrejte regjistrohen dhe ruhen për aq kohë sa e kërkon ligji për qëllime dëshmie.

10. Cilat janë të drejtat tuaja për mbrojtjen e të dhënave?

Të drejtat tuaja si subjekt i të dhënave përfshijnë:

- E drejta për të qenë të informuar — Keni të drejtën të informoheni rreth mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave tuaja personale.
- E drejta për qasje — Keni të drejtë të keni qasje në dhe të pranoni një kopje të të dhënave tuaja personale.
- E drejta për korrigjim — Keni të drejtën t'i korrigjoni të dhënat tuaja personale të pasakta apo t'i plotësoni nëse janë të paplota.
- E drejta për fshirje (e drejta për t'u harruar) — Ju keni të drejtën që të dhënat tuaja personale të fshihen, nën disa kushte të caktuara.
- E drejta për të kufizuar përpunimin — Ju keni të drejtën të kërkonti kufizimin e përpunimit të të dhënave tuaja personale, nën disa kushte të caktuara.
- E drejta për bartjen e të dhënave — Ju keni të drejtën të merrni të dhënat personale që Banka ka për ju dhe t'i ripërdorni ato për qëllimet tuaja, si për shembull t'i ruani për përdorim personal ose t'i transmetoni tek një kontrollues tjetër i të dhënave.
- E drejta për të kundërshtuar — Keni të drejtën të kundërshtoni përpunimin e të dhënave tuaja personale nga Banka, me disa kushte. Për shembull, keni të drejtën absolute që të kundërshtoni përdorimin e të dhënave tuaja personale për marketing direkt.
- Të drejta në lidhje me vendimmarrjen dhe profilizimin e automatizuar — Keni të drejtën të kërkonti nga Banka që të mos i nënshtroheni vendimit i bazuar vetëm në përpunimin e automatizuar, përfshirë profilizimin, për shembull, refuzimin automatik të aplikimit për kredi online.

Banka do t'i përgjigjet kërkesës tuaj pa vonesë dhe brenda një muaji, nëse vendosni të ushtroni ndonjë nga të drejtat e lartpërmendura.

11. Cilat janë kërkesat për qasje në të dhënat e subjekteve?

Subjektet e të dhënave, të cilëve Banka i'u mban të dhëna personale dhe të dhëna të tjera, kanë të drejtë të:

- Kërkojnë se çfarë informacioni rreth tyre mban Banka dhe pse
- Kërkojnë si të kenë qasje në atë informacion
- Jenë të informuar se si t'a përditësojnë informacionin
- Jenë të informuar se si Banka i përmbush detyrimet e veta për të dhëna

Ky informacion mund të kërkohet direkt përmes një kërkesë për qasje nga subjekti (SAR) që bëhet me anë të emailit në adresën kaltrina.haxha@procredit-group.com. Banka gjithnjë do ta verifikojë identitetin e kujtdo që bën kërkesë për qasje para se të përcjellë çfarëdo informacioni.

12. Kur mund t'i transferojë Banka të dhënat tuaja personale?

Banka mund t'ia shpalosë të dhënat personale palës së tretë në lidhje me dhe në varësi të shërbimeve që ofrohen, në rastet kur kjo shpalosje përfshin transferimin e të dhënave personale me filiale të Bankës, Grupit ProCredit, apo palëve të treta që i përpunojnë të dhënat tuaja me leje.

Banka do t'ia transferoj të dhënat palës së tretë vetëm kur kjo kërkohet me ligj ose nëse ju keni dhënë pajtimin për transferim. Banka mund t'ia transferojë të dhënat tuaja personale:

- **Autoriteteve:** Autoritetet mbikëqyrëse dhe autoritetet tjera rregullative dhe publike, si qeveria lokale, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), Njësia e Inteligjencës Financiare, Administrata Tatimore e Kosovës; IRS-ja; agjencite e tjera të zbatimit të ligjit dhe parandalimit të mashtrimit, dhe autoriteti anti-korrupsion.
- **Përfaqësuesve tuaj të autorizuar:** Individ ose organizatë që jep udhëzime ose menaxhon llogari, produkte ose shërbime në emrin tuaj, si Prokuroria, avokati, ndërmjetësuesit, bartësit e llogarisë së përbashkët, bashkëdeborët, garantuesit.
- **Palët e treta:** Entitete për të cilat Banka ka nevojë për të kryer pagesa si Visa, Mastercard, emetues të kartave të kreditit dhe banka tregtare, banka korrespondente, administratorë të ATM-se, kompani që merren me përpunimin e pagesave me karta, përfituesit tuaj, SWIFT, TARGET 2 SEPA, sistemet vendore të kliringut ose sistemet e barazimit, të ashtuquajtur KIPS, RLB (regjistri i llogarive bankare), Regjistri i Pengut që menaxhohet nga MTI dhe Regjistri i Hipotekës që menaxhohet nga Zyra e Kadastrës.
- **Institucione të tjera kreditore ose financiare:** Anëtarët e Grupit ProCredit, institucionet kreditore dhe financiare që ofrojnë financim si Fondi Evropian për Investime.
- **Të tjerë:** Kompani që ofrojnë shërbime për qëllime të përmbushjes së interesave tona legjitime ose detyrimeve kontraktuale si këshilltarët ligjorë të jashtëm, noterët, kompanitë e vlerësimit të pronave, sigurimet, auditorët, kontabilistët, kompanitë e marketingut dhe reklamave, kompanitë për ruajtjen, arkivimin dhe asgjësimin e dokumentave, kompanitë për ruajtjen e informatave online, ofrues të shërbimeve të TI dhe telekomunikimit, kontraktorë për zhvillim të softuerëve, kompanitë e shtypit.

Kur të dhënat transferohen, transferimi ndodh vetëm në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L – 082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nëse vendi apo organizata ndërkombëtare në fjalë siguron nivelin e duhur të mbrojtjes së të dhënave.

13. Cila është periudha për ruajtjen e të Dhënave Personale apo kriteret për përcaktimin e periudhës së ruajtjes?

Periudha e ruajtjes së të dhënave personale varet nga kategoria e atyre të dhënave personale dhe qëllimet për të cilat përpunohen. Sidoqoftë, të dhënat personale përpunohen për aq kohë sa është e nevojshme për bankën që të kryejë detyrimet e veta në lidhje me qëllimin për të cilin janë marrë këto të dhëna personale apo ashtu si kërkohet me kornizat e zbatueshme ligjore dhe rregullative.

Banka do t'i përpunojë të dhënat tuaja personale edhe pas përfundimit të marrëdhënies kontraktuale, për aq kohë sa kërkohet për të përmbushur detyrimet ligjore por edhe kërkesat për dokumentim.

Për shembull, të dhënat personale që kanë të bëjnë me informata për llogarinë ruhen për 6 vite nga data e mbylljes së llogarisë.

Banka e arsyeton periudhën e ruajtjes në bazë të qëllimeve për përpunimin e të dhënave personale dhe respekton detyrimet statutorë për ruajtjen e të dhënave. Nëse të dhënat personale nuk kërkohen më, ato do të fshihen në përputhje me proceset tona të fshirjes ose do të anonimizohen, pra do të zhvishen nga të gjitha karakteristikat e mundshme identifikuese.

14. Çfarë janë Cookies?

Uebfaqja e Bankës përdor cookies. Cookies janë dosje teksti që ruhen në sistemin e kompjuterit përmes shfletuesit të internetit. Shumë faqe dhe serverë në internet përdorin cookies. Shumë cookies përmbajnë një të ashtuquajtur ID e cookie. ID e cookie është identifikuesi unik i cookie. Ai përmban një varg karakteresh nëpërmjet të cilëve faqet dhe serverët në internet caktohen pranë shfletuesit specifik të internetit ku është ruajtur cookie. Kjo bën të mundur që faqet dhe serverët në internet që janë vizituar të bëjnë dallimin ndërmjet shfletuesit individual të subjektit të të dhënave nga shfletues të tjerë në internet që kanë cookie të tjera. Një shfletues specifik në internet mund të njihet dhe të identifikohet duke përdorur ID unike të cookie.

15. Çfarë lloj të të dhënave të përgjithshme dhe informacionit mbledh Banka?

Banka mbledhë një sërë të të dhënave të përgjithshme dhe të informatave kur një subjekt i të dhënave apo sistem i automatizuar e thërret uebfaqen. Këto të dhëna të përgjithshme dhe informata ruhen në regjistrat e serverit dhe përfshijnë:

- Llojet dhe versionet e shfletuesit (browser) të përdorur
- Sistemin operativ të përdorur nga sistemi për qasje
- Uebfaqja prej nga sistemi i qasjes arrin në uebfaqen tonë (të ashtuquajturit “referrers”)
- Nën-uebfaqet
- Datën dhe kohën e qasjes së faqes në internet
- Adresën e protokollit në internet (adresa IP)
- Të dhëna të tjera të ngjashme dhe informacion që mund të përdoret në rast të sulmeve ndaj sistemeve tona të teknologjisë së informacionit.

16. Përse Banka përdor cookies dhe mbledh të dhënat e përgjithshme dhe informacionin?

Banka përdor cookies që përdoruesve t’u japë një uebfaqe me shërbime më miqësore ndaj tyre që nuk do të ishte e mundur pa konfigurimin e cookies. Nëpërmjet cookies, informacioni dhe ofertat në uebfaqe mund të optimizohen duke pasur në mendje përdoruesin. Cookies gjithëashtu na lejojnë që t’i njohim përdoruesit e uebfaqes. Qëllimi i kësaj njohjeje është që për përdoruesit të bëhet më e lehtë që t’a shfrytëzojnë uebfaqen. Përdoruesi i uebfaqes që përdor cookies, p.sh. nuk ka nevojë të shënojë të dhënat për qasje sa herë që qaset në uebfaqe, sepse këtë e merr përsipër uebfaqja dhe kështu, cookie ruhet në sistemin kompjuterik të përdoruesit.

Gjatë përdorimit të të dhënave të përgjithshme dhe informacionit të lartpërmendur, Banka nuk nxjerrë asnjë konkluzion për subjektin e të dhënave. Ky informacion nevojitet për të:

- Dërguar saktë përmbajtjen e uebfaqes
- Optimizuar përmbajtjen e uebfaqes si dhe reklamat e saj
- Siguruar realizueshmëri afatgjatë të sistemeve tona të teknologjisë informative dhe teknologjisë së uebfaqes
- Siguruar për autoritetet e zbatimit të ligjit informacionin e nevojshëm për ndjekjen penale në rast të sulmeve kibernetike

17. Si munden përdoruesit t'i menaxhojnë cookies?

Subjekti i të dhënave mundet në çdo kohë të parandalojë konfigurimin e cookies përmes uebfaqes duke përdorur konfigurimin korrespondues të shfletuesit të internetit të përdorur, dhe kështu mund të mohojë në baza të përhershme konfigurimin e cookies. Për më tepër, cookies të konfiguruar mund të fshihen në çdo kohë nëpërmjet shfletuesit të internetit ose programeve të tjera softuerike. Kjo është e mundur në të gjithë shfletuesit e popullarizuar të internetit. Nëse subjekti i të dhënave ç'aktivizon konfigurimin e cookies në shfletuesin e përdorur të internetit, jo të gjitha funksionet në uebfaqe mund të jenë tërësisht të përdorshme.

18. Analitika e Google (Google Analytics)

Në uebfaqen e vet, Banka ProCredit ka integruar komponentin e Google Analytics (me funksionin e anonimizimit). Google Analytics është shërbim analitik në internet. Analitika në internet është mbledhja, grumbullimi dhe analizimi i të dhënave rreth sjelljes së vizitorëve në uebfaqe. Shërbimi i analitikës në internet mbledhë ndër të tjera të dhëna rreth uebfaqes prej nga ka ardhur personi (ashtuquajtur referues), cilat nënfaqe ka vizituar apo sa shpesh dhe për çfarë kohëzgjatje është shikuar një nënfaqe. Analitikën e internetit kryesisht përdoren për optimizimin e uebfaqes dhe për të bërë analizën e kosto-përfitimit të reklamimit në internet. Operatori i komponentit Google Analytics është Google Inc., 1600 Amphitheatre Pkwy, Mountain View, CA 94043-1351, SHBA.

Për analitikën në internet nëpërmjet Google Analytics, Banka ProCredit përdor aplikacionin "_gat._anonymizeIp". Me anë të këtij aplikacioni, adresa e IP në lidhjen me internetin e subjektit të të dhënave shkurtohet nga Google dhe anonimizohet kur qaset uebfaqen tonë. Qëllimi i komponentit të Google Analytics është të analizojë trafikun në uebfaqen tonë. Google i përdor të dhënat dhe informacionin e mbledhur ndër të tjera edhe për të vlerësuar përdorimin e uebfaqes sonë dhe për të gjeneruar raporte online, që tregojnë aktivitetet në uebfaqet tona si dhe për të ofruar shërbime të tjera që kanë të bëjnë me përdorimin e faqes së internetit për ne.

Informacione të mëtejshme dhe dispozitat e zbatueshme për mbrojtjen e të dhënave nga Google mund të gjenden në <https://www.google.com/intl/en/policies/privacy/> dhe në <http://www.google.com/analytics/terms/us.html>. Google Analytics shpjegohet më tej në linkun e mëposhtëm <https://www.google.com/analytics/>

19. Përpunimi i të dhënave gjatë përdorimit të aplikacionit “Biseda me Klient”

Nëse përdorni aplikacionin “Biseda me klient (ProBot)” në uebfaqen tonë apo brenda aplikacionit tonë, adresa juaj e IP-se dhe informacioni që na jepni gjatë komunikimit në dritaren e bisedës mblidhet dhe përpunohet. Ne i përpunojmë të dhënat tuaja aq sa është e nevojshme për të përmbushur kontratën me ju ose për të ndërmarrë masat parakontraktuale që keni kërkuar. Gjithashtu, ne i përpunojmë të dhënat tuaja brenda fushëveprimit të interesave tona legjitime për aq sa kjo është e nevojshme për t'iu dhënë përgjigje pyetjeve tuaja të përgjithshme rreth shërbimeve dhe produkteve tona dhe për t'ju ndihmuar që të gjeni informacion rreth shërbimeve dhe produkteve tona të reja.

20. Azhurnimet e Njoftimit të Privatësisë

Banka ruan të drejtën t'a ndryshojë njoftimin e privatësisë herë pas herë për të pasqyruar shërbimet e reja, ndryshimet në praktikën tona dhe respektuar çdo ndryshim ligjor dhe rregullativ që mund të ndikojë mbi përgjegjësitë tona ndaj klientëve tanë. Legjenda “azhurnuar së fundmi” në krye të njoftimit të privatësisë tregon se kur është rishikuar së fundmi ky dokument. Të gjitha ndryshimet hyjnë në fuqi sapo të postohen në praninë tonë online.